



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3491 Prot

Tiranë, më 10/06/2020

URDHËR

Nr. 146, datë 10.06.2020

“PËR

**FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE KARAKTERISTIKAT E TJERA TË VULAVE, SI
DHE RREGULLAT PËR PAJISJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 69, pika 4, të ligjit nr.110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Noteri për ushtrimin e veprimtarisë së tij duhet të jetë i pajisur me vulën e thatë dhe vulën e njomë.
2. Vula e thatë ka formë rrethore me diametër 50 mm e konturuar nga një rreth. Brenda saj është konturuar një rreth më i vogël me diametër 30 mm. Në hapësirën ndërmjet rrethit të brendshëm dhe të rrethit të jashtëm të vulës janë shkruar në formë të harkuar me shkronja të mëdha fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”. Poshtë tyre, në formë të harkuar në të kundërt të fjalëve të mësipërme, është shkruar emri i Bashkisë ku zhvillon veprimtarinë noteri. Në hapësirën brenda rrethit të vogël, të renditura poshtë fjalëve “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”, janë shkruar në formë të harkuar, me shkronja të mëdha, emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i noterit. Në mes të rrethit të vogël është konturuar shqiponja dykrenare dhe poshtë saj, në formë të harkuar në të kundërt të emrit e mbiemrit të noterit është shkruar me shkronja të mëdha fjala “NOTER”.
3. Vula e njomë ka formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj janë shkruar në formë të harkuar me shkronja të mëdha fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”. Poshtë tyre me shkronja të mëdha, por më të vogla si madhësi, në një rresht të dytë në formë të harkuar vendoset emri,

- shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i noterit. Në mes konturohet shqiponja dykrenare dhe poshtë saj në formë të harkuar në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të noterit është shkruar me shkronja të mëdha, por të të njëjtës madhësi me ato të emrit, fjala “NOTER”. Poshtë kësaj fjale, me shkronja të mëdha, por të të njëjtës madhësi me ato të fjalëve “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe në formë të harkuar në të kundërt me to, është shkruar emri i qytetit ku zhvillon veprimtarinë noterit.
4. Përgatitja e vulave bëhet nga subjekte shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur nga subjekte private shqiptare ose të huaja, që e ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente.
 5. Personi, që merr për herë të parë licencën për ushtrimin e profesionit të noterit, noterit që transferohet, noterit, të cilit i janë dëmtuar vulat dhe noterit, të cilit i kanë humbur vulat, i paraqesin kërkesën për t’u pajisur me vula Dhomës Kombëtare të Noterisë. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë se personi lejohet të pajiset me vulat e noterit, si dhe me të dhënat e nevojshme për përgatitjen e vulave.
 6. Në rastin e vulave të reja, për shkak se kanë humbur të mëparshmet, matrica e vulës së re duhet të ketë detyrimisht një vendosje të ndryshme topografike të mbishkrimeve të saj, që e bëjnë të dallueshme nga vula e mëparshme.
 7. Pasi janë përgatitur, vulat i dorëzohen përfaqësuesit të caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë në prani edhe të personit të ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë. Vulat merren në dorëzim me procesverbal të firmosura nga të dy përfaqësuesit e përmendur më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Vulat ruhen dhe nuk përdoren deri në ceremoninë e betimit, kur do t’i dorëzohen noterit.
 8. Në rastin e vulave të reja të noterëve që u janë zëvendësuar vulat, për arsye se u kanë humbur ose u janë dëmtuar, ato i paraqiten drejtorit të drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë apo personit të ngarkuar prej tij, i cili, pasi i verifikon, i kërkon noterit t’i firmosi dhe vulosë, me vulat që do të përdorë, fletë të bardha format “A 4”. Këto fletë nevojiten për t’u depozituar në dosjen personale dhe për t’iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues. Për këtë procedurë hartohet procesverbali përkatës dhe më pas vulat i dorëzohen noterit.
 9. Procedurat e përgatitjes së vulave nga Dhoma Kombëtare e Noterisë duhet të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lëshimit të licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.
 10. Në rast të mosrespektimit të afatit të sipërpërmendur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, procesi i përgatitjes së vulave drejtohet dhe organizohet nga Ministria e Drejtësisë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë urdhër.
 11. Pajisja e noterit me vula bëhet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë në ambientet dhe në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, në çastin kur bën betimin.
 12. Ministria e Drejtësisë njofton me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë 10 ditë përpara për ditën dhe orën e kryerjes së ceremonisë së betimit, si dhe për pjesëmarrësit dhe i kërkon caktimin e përfaqësuesve që do të drejtojnë procesin e pajisjes me vula. Në rast mosparaqitjeje pa arsye, ceremonia zhvillohet pa pjesëmarrjen e tyre dhe noterëve të rinj u dorëzohen vulat, duke pasqyruar në procesverbal gjithë veprimtarinë.
 13. Në rastin e notereve të transferuar ose të cilëve u jepet vula pas përfundimit të kohës së pezullimit nga detyra, Ministria e Drejtësisë njofton me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë për detyrimin e drejtimit të procesit dhe për të caktuar përfaqësuesit e saj 10 ditë përpara ditës kur noterëve do t’u dorëzohet vula.

14. Nëse përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Noterisë nuk mund të marrin pjesë në proces për arsye objektive, procesi i dorëzimit të vulave do të zhvillohet një ditë tjetër, por jo më vonë se 15 ditë nga dita e caktuar më parë. Në rast se mospjesëmarrja e përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Noterisë është e pajustificueshme, si dhe kur edhe pas caktimit të një date tjetër, si më sipër, përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë nuk mund të marrë pjesë, vulat u dorëzohen noterëve nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë duke pasqyruar gjithçka në procesverbalin përkatës.
15. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e profesioneve të lira në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga noteri. Procesverbali pasqyron kohën, vendin, emrin e pjesëmarrësve dhe faktin e marrjes së vulës në dorëzim nga noteri. Procesverbali nënshkruhet nga personat e sipërpërmendur duke i dhënë një kopje të tij Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe një kopje depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë.
16. Drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë kërkon nga personat të firmosin dhe të vulosin me vulat e reja në fletë të bardha format "A 4", të cilat nevojiten për t'u depozituar në dosjen personale dhe për t'iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues.
17. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga Ministri i Drejtësisë se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e noterisë u dërgohet zyrtarisht, për çdo noter, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulat e tij.
18. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo noterit i dërgohet për depozitim e model ministrisë përgjegjëse për rendin publik, ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, prokurorive dhe gjykatave.
19. Noteri i pajisur me vulë është i detyruar të kujdeset për ruajtjen e saj nga dëmtimet, vjedhjet dhe përdorimin nga të tretët.
20. Vula është personale dhe përdoret vetëm nga noteri dhe në rastet e përcaktuara në ligj nga zëvendësnoteri. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t'i jepet në asnjë rrethanë të tretëve.
21. Në rast se gjatë kontrolleve, konstatohet se vula e noterit përdoret nga persona të tretë, me përjashtim të zëvendësnoterit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë të ngarkuar me kontrollin, pasqyrojnë faktin në procesverbalin përkatës.
22. Në rast se shkelet detyrimi i ruajtjes dhe përdorimit të vulës, ndaj noterit dhe/ose zëvendësnoterit, në varësi të rëndësisë së shkeljes së konstatuar, Ministria e Drejtësisë dhe/ose Bordi Disiplinor i Noterëve, ka të drejtë të marrë një nga masat disiplinore sipas parashikimeve përkatëse të ligjit për noterinë.
23. Akti ose veprimi noterial është i pavlefshëm në rast se nuk përmban vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe vulën e njomë në lidhjen e dokumenteve dhe/ose mbi pullën e taksës. Kur dokumenti ka shumë fletë, ato lidhen zakonisht në cepin e majtë sipër ose në anën e majtë dhe duke u përthyer një nga një në vendin e lidhjes vulosen me vulën e njomë, forma e së cilës del pjesërisht në çdo fletë. Në rast se dokumenti ka shumë fletë dhe ato nuk mund të lidhen me vulë si më sipër, vihet nga një vulë e njomë në çdo faqe të shkruar dhe në vërtetim shënohet numri i faqeve të shkruara kur nuk janë të numërtuara.
24. Urdhri nr. 8045, datë 2.12.2004 i Ministrisë së Drejtësisë, "Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve", të ndryshuar, shfuqizohet.

25. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe zëvendësnoterët.
26. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Etilda Gjona (Saliu)

